

MARRËVESHJE PËR BLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot më datë 14.06.2024 (dymijë e njëzet e katër), lidhet kjo marrëveshje për shitblerje kuotash ndërmjet paleve si në vijim:

1. **Shoqëria "Green Coast" Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, me seli në Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tiranë, Shqipëri", përfaqësuar nga administratori Z. Armando Alicanaj, shtetas shqiptar, lindur më 05.10.1979, në Fier, mbajtës i pasaportës me nr. BC5216331, dhe me numër personal H91005012U, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (më poshtë referuar si "**Shitës**")
2. **Shoqëria "BOLV OIL" Sh.a.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K32528408H, me seli në adresë Grize Patos, Zona Kadastrale 2890, Pasuria Nr. 68/3, përfaqësuar nga Administratori Z. Agron Bulku (më poshtë referuar si "**Blerës**")

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuotë me një vlerë nominale prej **855,100 LEK** (tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Seaside Residence V" sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti Nr. 31, Tiranë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M11419021G, përfaqësuar nga Administratori Z. Armando Alicanaj ("**Kuota**").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të **1 (një)** kuotë me një vlerë nominale prej **855,100 LEK** (tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Seaside Residence V" sh.p.k.**, dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabartë me **970,000 LEK** (nëntëqind e shtatëdhjetë mijë lekë), (këtu e tutje referuar si "**Çmimi**").
3. Blerësi do të paguajë brenda ditës së nesërme të firmosjes së kësaj kontrate çmimin e plotë prej **970,000 LEK** (nëntëqind e shtatëdhjetë mijë lekë), në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:

Emri i Bankës: Tirana Bank SH.A.
Titullari i llogarisë: Green Coast Sh.p.k.
NR.Llogarie: 0110-319705-101
IBAN: AL49 2061 1011 0000 1103 1970 5101
Monedha: ALL

4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe në çdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e

Kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e Çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e pronësisë së Kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.

6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Blerësi angazhohet të bëjë njoftimin e përqendrimit dhe të kësaj marrëveshjeje, pranë Autoritetit të Konkurrencës, në rastin kur kjo përbën kusht për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9121 dt 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar, dhe në çdo rast do të mbajë të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga mospërmbushja e këtij detyrimi, ndaj institucioneve shtetërore përkatëse dhe ndaj Shitësit.
9. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
10. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimi të kësaj marrëveshje.
11. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje me përmbajtje dhe fuqi të njëjtë ligjore.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Armando Alicanaj

Green Coast Sh.p.k.

përfaqësuar nga Z. Armando Alicanaj

GREEN COAST
L41329038D

BLERËSI

Agron Bulku

BOLV OIL Sh.a.

përfaqësuar nga Z. Agron Bulku

